Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/203
Datë 25.06.2020

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-189 "Për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të nenit 42 të Ligji Nr. 05/L -031 "Për procedurën e përgjithshme administrative", të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 "Për Kualifikimet Kombëtare" dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 – "Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë", Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 28/2014 "Per kriteret dhe procedurat per verifikimin e standardit të profesionit", Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 08.06.2020, shqyrtoi propozim dokumentin përkatës për lejimin e zhvillimit te takimeve virtuale në distancë për proceset që zhvillon AKK, dhe nxjerr këtë:

VENDIM

Për lejimin e zhvillimit të takimeve virtuale në distancë dhe të përshtatura
për proceset që zhvillon AKK përgjatë periudhës së pandemisë

1. Përgjatë periudhës së pandemisë, ne te cilën janë ne fuqi masat e aplikuara nga Qeveria e Republikës se Kosoves, sipas Vendimit Nr.01/07 te datës 11 .03.020, dhe në situatat e tjera emergjente që mundë të shpallen, lejohet zhvillimi i takimeve virtuale në distancë për proceset që zhvillon AKK, bazuar në legjislacionin në fuqi.

2. Obligohet AKK që përmes një dokumenti të veçantë-Qarkores informative, përgjatë periudhës së pandemisë, si një zëvendësim i përkohshëm dhe opsion alternativ i dispozitave përkatëse të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 – "Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve", nenit 11, pika 1.3.2 dhe neni 15, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 28/2014 "Për kriteret dhe procedurat per verifikimin e standardit të profesionit", nenit 8, pika 3.3, të përcaktoj kushtet si dhe të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 09/2019 – "Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë njohjen e mësimit paraprak në Kosovë", nenit 09, pika 1.2.1.2, procedurën dhe kriteret përkatëse për zhvillimin e procedurës për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve si dhe verifikimin e standardit të profesionit.

3. Obligohet AKK që me dokumentin e miratuar sipas pikës 3 të këtij vendimi, të njoftoj të gjitha IAAP-ët aplikues në AKK.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet.

- Te gjitha IAAP aplikuese
- Zyrës se Drejtorit të Përgjithshëm të AKK
- Arkivit të AKK

Kryetarja e KD së AKK-së

Violeta Dema